

VENDIM
Nr. 147, datë 4.10.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU)” SHA, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, të nenit 5, pika 1, germa “d”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 4.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 92/2 prot., datë 30.9.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519 prot., datë 27.8.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike;

- në zbatim të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe të urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues, në datën 28.3.2018 është themeluar shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), për kryerjen e aktivitetit të furnizimit;

- ERE, me vendimin nr. 215, datë 11.10.2018, transferoi licencën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, dhe të detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.);

- pas konstatimit se ky aplikim është kryer nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a. dhe jo nga shoqëria e krijuar për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), ERE, me shkresën nr. 519/1 prot., datë 12.9.2019, iu drejtua shoqërisë OSHEE sh.a. dhe për dijeni shoqërisë FSHU sh.a., duke i bërë me dije se aplikimi për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike nr. 251, seria P14FPP, duhet të kryhet nga shoqëria FSHU sh.a.;

- në përgjigje të sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519/2, datë 17.9.2019, ka përcjellë aplikimin për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “e” dhe “f”, pika 4.7.1, gjerat “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë, me:

- “dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, neni 9, pika 2, gjerma “c” (Vërtetimi i regjistrimit nga QKB-ja), pavarësisht se nga ekstrakti i QKB-së rezulton se shoqëria FSHU sh.a. është regjistruar në QKB, në datën 30.3.2018, me NUIS L81530016L, ajo nuk ka përcjellë në ERE dokumentin “Certifikatë e regjistrimit”; do të njoftohet aplikuesi, që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë në ERE, brenda afateve;

- vërtetimet nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, të lëshuara për shoqërinë FSHU sh.a., do të kërkohet që të depozitohen në ERE, në zbatim të nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të lëshuara jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti